



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:070525

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03081910

**PKR.nr.55/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Merita Xharavina, zyrtare ligjore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda PP/L.nr.154/2022 të datës 08.04.2022, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me datë 06.05.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarit B. M. dhe mbrojtëses së tij, Av. Feride Xani nga Gjakova, me datë 12.05.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 31.05.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari,

B. M., nga i ati H. dhe e ëma Sh., e gjinisë Gj., i lindur me datë ....., në Gjakovë, ku edhe tani jeton, në rr."K. e B.", nr..., me nr. personal ....., ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, rrobaqepës, i divorcuar, atë i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar,

**ËSHTË FAJTOR**

Pasi që më parë ka siguruar e gjerë me dt.31.05.2021, rreth orës 12:10, ka mbajtur në pronësi armë në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par. 1.1 të ligjit nr.05/L-022, për Armët dhe atë: një "Pistoletë TT", me nr.serik....., prodhim jugosllav, me dy karikator të zbrazët dhe 90 (nëntëdhjetë) fishekë kal.7.62x25mm, një Automatik PPS-42, me nr.serik....., prodhim kinez, me një karikator dhe 205 (dyqind e pesë) fishekë kal.7.62x25mm, një AK-47, me nr.serik....., prodhim kinez, me dy karikator dhe 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fishekë kal.7.62x39mm dhe 400 (katërqind) fishekë kalibër 7.62x39mm në 20 paketime, në atë mënyrë që ditën kritike Sh. U., kishte raportuar në Stacionin Policor në Gjakovë, rastin e dhunës në familje nga bashkëshorti i saj, tani i pandehuri B. M., dhe njëkohësisht kishte dorëzuar një çantë të vogël në të cilën kishte një Pistoletë, pronë e të pandehurit, si dhe ka raportuar se i njëjti posedon edhe armë të tjera në podrumin e shtëpisë, ashtu që pas kontrollit të shtëpisë, objekteve ndihmëse dhe podrumit të

shtëpisë së të pandehurit në Gjakovë, nga zyrtarët policor i janë gjetur armët e lartcekura, të cilat janë sekuestruar nga ana zyrtarëve policor.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40 par. 1, nën-par.1.2, 42, 69 e 70, 71 dhe 72 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe neni 366 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 dhe 3 të KPRK-së (Kodi Nr. 06/L- 074), si dhe neneve 245, 248, 360, 361 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, të cilin dënim do ta vuaj pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pasi që gjykata ka caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, i akuzuari dhe mbrojtësja e tij, av. Feride Xani, kanë kërkuar që dënimi me burgim i shqiptuar si më lart, ti zëvendësohet me dënim me gjobë.

Kryetari i trupit gjykues pas propozimit të mbrojtëses së të akuzuarit, av. Feride Xani, tërhiqet për këshillim, dhe më pas ka vendosur që në kuptim të nenit 44 e lidhur me nenin 43 të KPRK-së, të akuzuarit B. M. dënimin me burgim të shqiptuar si më lart, t'ia zëvendësoj me:

## **DËNIM ME GJOBË**

Në shumën e përgjithshme prej dymijë e pesëqind (2,500) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet e pesë (125) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) Euro me një (1) ditë burgim.

Ndaj të akuzuarit B. M., bëhet konfiskimi i:

-një "Pistoletë TT", me nr.serik....., prodhim jugosllav, me dy karikator të zbrazët dhe 90 (nëntëdhjetë) fishekë kal.7.62x25mm;

-një Automatik PPS-42, me nr.serik....., prodhim kinez, me një karikator dhe 205 (dyqind e pesë) fishekë kal.7.62x25mm, dhe

-një AK-47, me nr.serik....., prodhim kinez, me dy karikator dhe 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fishekë kal.7.62x39mm, si dhe 400 (katërqind) fishekë kalibër 7.62x39mm në 20 paketime.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet (armët dhe municioni) e konfiskuara do të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se të njëjtat janë përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L022).

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë:

- në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, dhe
- në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën, PP/L.nr.154/2022 të datës 08.04.2022, ndaj të pandehurit B. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe të njëjtën e ka dorëzuar në gjykatë, me datë 08.04.2022.

Gjykata, me datë 06.05.2022, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë marrë pjesë: Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, i pandehuri B. M., së bashku me mbrojtësen e tij, Av. Feride Xani nga Gjakova, e angazhuar sipas autorizimit.

Prokurorja e shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

### 2. Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit ia ka dhënë mundësinë që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprkisht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që ngarkohet.

I akuzuari, pas konsultimit me mbrojtësen e tij, ka deklaruar, se: E pranon fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet dhe e ka pranuar se armët kanë qenë të tij.

Mbrojtësja i të akuzuarit, avokatja Feride Xani nga Gjakova, duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka theksuar se: pajtohet plotësisht me pranimin e fajësisë së të mbrojturit të saj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, i njëjti pas konsultimit të mjaftueshëm dhe sqarimit të pasojave dhe beneficioneve lidhur me pranimin e fajësisë ka pranuar fajin me vullnetin e tij të plotë dhe e pa ndikim.

Andaj, e ka lutur gjykatën që me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh disa rrethana lidhur me të mbrojturin si: i njëjti është prind i dy fëmijëve të mitur 4 dhe 11 vjeçar, të cilët janë braktisur nga nëna dhe babai i tyre është duke u përkujdesur për ta dhe për nënën e tij në moshë të shtyer dhe me sëmundje kronike. Po ashtu, djali i të pandehurit A. lëngon nga sëmundja e mushkërive – bronhitis, i cili është në trajtim të vazhdueshëm dhe në kujdes të vazhdueshëm nga i ati, si provë lidhur me këto rrethana gjykatës ia dorëzoi dokumentacionin mjekësor të nënës dhe djalit të pandehurit, i cili pos që lëngon nga sëmundja kronike, për momentin ka pësuar edhe lëndime në dorë – frakturë, kështu që i nevojitet përkujdesje e vazhdueshme nga personi i tretë, në rastin konkret nga babai, si rrethanë tjetër lehtësuese e ka lutur gjykatën ta ketë parasysh edhe faktin se i njëjti asnjëherë deri më tani nuk ka ra ndesh me ligjin, nuk ka të kaluar kriminale, është një person i rregullt i cili në vazhdimësi është kujdesur për familjen e tij dhe vet pranimi i fajësisë të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, kështu që e ka lutur gjykatën që nëse dënimi për veprën e tij do të jetë me burg, atëherë këtë dënim ta shndërroi në të holla.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, ftohet prokurori i shtetit që të jap mendimin rreth pranimit të fajësisë.

### 3. Deklarimet e palës lidhur me pranimin e fajësisë

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, ka deklaruar se: nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti ka mbështetje në shkresat e lëndës, kësaj gjykate i ka propozuar që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

### 4. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga nenet 246 dhe 248 par. 1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues sidomos duke u mbështetur në vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka aprovuar pranimin e fajësisë së të njëjtit dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e ka marrë në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Deklarata e të pandehurit B. M., dhënë në Polici me dt.31.05.2021 dhe në Prokurori, me dt.07.04.2022;
- Raporti fillestar i incidentit, i dt.31.05.2021;
- Vërtetimi mbi sekuestrumin e sendeve, të dt. 31.05.2021;
- Raporti i Policit K. H., i dt. 31.05.2021;
- Aktvendimi për Fillimin e Hetimeve, i dt. 07.04.2022;
- Raporti i Bastisjes i dt.31.05.2021, si dhe
- Dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimit të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij, me ç'rast përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i akuzuari i lartcekur, është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohet.

### 5. Gjetjet e Gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit si dhe lidhur me konfiskimin

Gjykata, gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese, gjykata për të akuzuarin, ka vlerësuar dashjen direkte lidhur me veprën penale, e po ashtu edhe faktin se veprat penale të armëmbajtjes pa leje janë të shpeshta në regjionin ku jeton i akuzuari.

Gjykata, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, pasi që i njëjti është i gjendjes së mesme ekonomike, rrobaqepës dhe jeton në bashkësi familjare me prindërit dhe dy fëmijët, ka shprehur gatishmëri të lartë për bashkëpunim, si me organet e ndjekjes ashtu edhe me gjykatën, me ç'rast e ka pranuar fajësinë, pendimin e thellë për veprimet e tij, është hera e parë dhe e vetme që ka rënë në kundërshtim me ligjin, premtimin që në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën, e posaçërisht si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin se i njëjti është i divorcuar dhe kujdeset për djalin e tij i cili është i sëmurë dhe kërkon kujdes të vazhdueshëm.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari i ka kryer veprën penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjykata, në kuptim të nenit 282 paragrafi 1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPPRK-së, dhe nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm, dhe atë: një "Pistoletë TT", me nr.serik....., prodhim jugosllav, me dy karikator të zbrazët dhe 90 (nëntëdhjetë) fishekë kal.7.62x25mm, një Automatik PPS-42, me nr.serik....., prodhim kinez, me një karikator dhe 205 (dyqind e pesë) fishekë kal.7.62x25mm, Një AK-47, me nr.serik....., prodhim kinez, me dy karikator dhe 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fishekë kal.7.62x39mm dhe 400 (katërqind) fishekë kalibër 7.62x39mm në 20 paketime, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara do të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se të njëjtat janë përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L022).

## 6. Arsytet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.6, lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

## 7. Arsytet lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.55/2022 datë 31.05.2022**

**Zyrtarja Ligjore,**  
Merita Xharavina

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,**  
Ilir I. Rashkaj

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.